

VENDIM
Nr.753, datë 2.11.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1040, DATË 22.12.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN ZYRTAR TË NOMENKLATURËS
SË MALLRAVE, 2011”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 12 të ligjit nr.9461, datë 21.12.2005 “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr.1, bashkëlidhur vendimit nr.1040, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave, në pjesën e dytë, seksioni II “Produktet vegjetale”, kapitulli 7, “Zarzatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës”, pas kodit tarifar NK 0703 10 11 shtohet kodi tarifar 11-shifror, NK 0703 10 11 100, me katër viza (-----), me përshkrimin “Për mbjellje”, si kod i ri me trajtim tarifar favorizues.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me miratimin e nivelit të tarifës doganore përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha